



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale
Mbledhja nr. 24
Prishtinë, 02 dhjetor 2008, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

P R O C E S V E R B A L

I mbledhjes së Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Në mbledhje morën pjesë: Sadik Idriz, Rita Hajzeraj, Flora Brovina, Qamile Morina, Nurishahe Hulaj, Gjylnaze Sylja, Mimoza Ahmetaj, Armend Zemaj, Bujar Bukoshi dhe Teuta Hadri.

Mungoi: Sllobodan Petroviq.

Të pranishëm:

Nga Zyra e Komisioneve të Kuvendit: Shpresa Haxhijaj - administratore dhe Fatime Qorri - zyrtare ligjore.

Nga NDI-ja: Shefki Kastrati

Nga KDI-ja: Rrezarta Ahmeti

Mbledhjen e kryesoi z. Sadik Idriz, kryetar i Komisionit.

Komisioni i zhvilloi punimet me këtë

REND DITE

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar;**
- 3. Diskutim rreth monitorimit të Ligjit për ushtrimin e veprimtarisë private në shëndetësi;**
- 4. Shqyrtim i raportit përfundimtar për Projektligjin për rehabilitimin profesional dhe për punësimin e personave me aftësi të kufizuara;**
- 5. Të ndryshme.**

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet dhe e hapi mbledhjen lidhur me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

Kryesuesi konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes së kaluar pa vërejtje.

3. Diskutim rreth monitorimit të Ligjit për ushtrimin e veprimtarisë private në shëndetësi

Sadik Idriz – Tha se Komisioni e ka ngarkuar grupin e punës për monitorimin e Ligjit për ushtrimin e veprimtarisë private në shëndetësi. E ftoi kryesuesen e grupit të punës, deputeten Qamile Morina, për të na e paraqitur se deri ku ka ardhur me punë grupi i punës dhe çka propozon ky grup.

Qamile Morina – Tha se grupi i punës ka arritur t'i vizitohet gjashtë ambulanca private në Prishtinë dhe në Prizren, si dhe i ka vizituar dy kuvende komunale po ashtu në Prishtinë dhe në Prizren. Një prej këtyre ordinancave ka qenë e palicencuar. Kjo është bërë me qëllim që grupi i punës të merrte informata për problemet lidhur me licencimin. Nga ky monitorim grupi i punës konstatoi se Ligji për ushtrimin e veprimtarisë private në shëndetësi, diku rreth 70%, është i pazbatueshëm. Nga vizitat e realizuara është krijuar përshtypja se ky ligj në pjesën më të madhe nuk po zbatohet nga vetë Ministria e Shëndetësisë. Grupi i punës nuk arriti t'i vizitonte as 10 % të ordinancave të licencuara private, andaj propozon të organizohet një dëgjim publik, në të cilin të ftuarit do të mund t'i shprehin shqetësimet dhe rekomandimet e tyre lidhur me zbatueshmërinë e këtij ligji. Organizimi i dëgjimit publik vetëm se do ta ngrinte cilësinë e punës së Komisionit dhe do të ndihmonte që rekomandimet të ishin më të fuqishme.

Teuta Hadri – Tha se problemi më i madh është se Ministria e Shëndetësisë nuk ka arritur ta jepte kontributin e vet në zbatimin e Ligjit. Problemet po fillojnë në Ministrinë e Shëndetësisë dhe po vazhdojnë tutje. Ky ligj është miratuar në Kuvend dhe nga të gjithë shefat e grupeve parlamentare është konsideruar si një ndër ligjet më të mira. Është i panevojshëm organizimi i dëgjimit publik për arsye se ne jemi ata që e bëjnë monitorimin e zbatueshmërisë së këtij ligji. Dëgjimet publike bëhen para miratimit të ligjit.

Sadik Idriz - Tha se pajtohet të organizohet dëgjimi publik përafërsisht në kohën prej dhjetë ditësh. Dëgjimi publik mund të organizohet edhe për monitorim të ligjeve. Ne nuk jemi të interesuar për ndryshimin e Ligjit, por për mbikëqyrjen e zbatimit të tij.

Gjylnaze Syla – Tha se është më se i nevojshëm organizimi i dëgjimit publik dhe atë për arsye, se grupi i punës nuk ka arritur t'i vizitohet as 10% të ordinancave private. Për këtë shkak nuk e kemi të pasqyruar as 50 % të gjendjes. Ligji për ushtrimin e veprimtarisë private në shëndetësi është i pazbatueshëm. Ky dëgjim publik do të ishte i rëndësishëm edhe për Komisionin, sepse do të ftohen të gjithë faktorët që ndërlidhen me këtë ligj dhe vlerësimi se sa po zbatohet Ligji do të jetë më objektiv.

Flora Brovina – Tha se organizimi i dëgjimit publik është përsëritje e temës. Në kohën e miratimit të këtij ligji ka pasur dëgjim publik dhe janë dëgjuar pikërisht njerëzit që po i propozoni t'i ftoni. Në mandatin e kaluar janë dhënë 50 rekomandime për zbatimin e Ligjit për shëndetësi. Mirëpo ato rekomandime nuk janë zbatuar dhe nuk kanë ndihmuar në zbatimin e Ligjit. Ne mund ta bëjmë dëgjimin publik, por të punojmë jo sipas opinionit që e ka krijuar gazeta, por si deputetë dhe në mënyrë neutrale.

Rita Hajzeraj – Tha se e përkrah propozimin për mbajtjen e dëgjimit publik, meqenëse në këtë dëgjim do të jenë të ftuar edhe përfaqësuesit e Ministrisë së Shëndetësisë, që do të marrin rekomandime për zbatimin e këtij ligji.

Nurishahe Hulaj – Tha se para vetes i kemi raportet e ndara varësisht nga institucioni në të cilin grupi i punës ka bërë vizitë dhe konsideroi se ka mjaft material për hartimin e raportit përfundimtar për seancë. Ky raport duhet t'i përmbajë: qëllimin, aktivitetet, problematikën dhe rekomandimet. Grupi i punës duhet të jetë ai që do të vlerësojë a është i mjaftueshëm raporti apo duhet të organizohet një dëgjim publik?

Armend Zemaj – Tha se duhet ta kemi të qartë qëllimin e monitorimit të këtij ligji. E kuptoj deputeten Qamile Morina, që është opozitë dhe asaj i duhet marketing në dëgjime publike për ta sharë Ministrinë e Shëndetësisë. Grupi i punës duhet të punojë për qëllimin e monitorimit të Ligjit e jo në bazë të interesave individuale. Derisa grupi i punës nuk e ka përgatitur raportin final dhe nuk ka dalë me rekomandime, ne nuk mund të themi se Ministria e Shëndetësisë është problemi kryesor për zbatimin e këtij ligji. E dini që janë mbyllur klinikat, që janë akuzuar për krim të organizuar. Por, a ka faj këtu Ministria? Ne duhet të nxjerrim rekomandime dhe pastaj të vlerësojmë nëse informatat e mbledhura nga kjo kategori mjekësore janë apo nuk janë të mjaftueshme. Vetëm atëherë mund të vendosim për mbajtjen e dëgjimit publik.

Qamile Morina – Tha se në kohën kur Komisioni ka vendosur ta monitorojë këtë ligj janë paraqitur tre vullnetarë për t'u bërë pjese e këtij grupi: Armend Zemaj, Rita Hajzeraj dhe Mimoza Ahmetaj. Ajo tha se Armend Zemaj e ka propozuar atë që të jetë kryesuese e këtij grupi. Interesimi i saj për këtë si opozitë është paragykim. Qëllimi kryesor është - sa po zbatohet ky ligj. Nëse dikush është duke mbledhur pikë për politikë, këtë është duke e bërë pozita.

E ka arsyetuar propozimin për mbajtjen e dëgjimit publik për faktin se janë të licencuara 500 ordianca, kurse grupi i punës nuk ka arritur t'i monitorojë as 10 % të tyre. Çdo punim duhet të bazohet në informata të bollshme, meqë nëse nuk ka mjaft informata, atëherë raporti do të jetë pa vlerë.

Gjylnaze Sylja – Tha se ideja e monitorimit të këtij ligji nuk është pozitë as opozitë. Nëse pozita nuk dëshiron të mos mbahet dëgjimi publik, për shkak të mediave, atëherë Komisioni mund të vendosë që dëgjimin publik ta bëjë me dyer të mbyllura. Qëllimi është të kryhet puna. Për çka po frikësoheni të mbahet një dëgjim publik? Edhe në mandatin e kaluar ka parashtruar pyetje për ministrin se sa po zbatohet Ligji për shëndetësi dhe në atë kohë ajo ka qenë pozitë.

Armend Zemaj – Tha se ai asnjëherë nuk ka qenë kundër organizimit të dëgjimit publik, por konsideron se për mbajtjen ose për mosmbajtjen e dëgjimit publik duhet të vendosë Komisioni pasi të hartohet raporti me rekomandime.

Mimoza Ahmetaj – Lidhur me organizimin e dëgjimit publik, tha se duhet ta presim raportin me rekomandime. Po ashtu në seancën e radhës e kemi në interpelancë ministrin e Shëndetësisë dhe ai nuk do t'i ikë as praktikës private. Andaj të mos deklarohe mi sot, por të presim.

Kryesuesi i Komisionit i ftoi anëtarët të votojnë për propozimin që të mbahet një dëgjim publik lidhur me monitorimin e Ligjit për ushtrimin e veprimtarisë private në shëndetësi.

Kryesuesi konstatoi se nga nëntë anëtarët e pranishëm katër janë pro organizimit të dëgjimit publik në këtë kohë, ndërsa pesë nuk janë kundër organizimit të dëgjimit publik, por le të vendoset që ky dëgjim të mbahet pasi të jetë hartuar raporti me rekomandime.

3. Shqyrtim i raportit përfundimtar për Projektligjin për rehabilitimin profesional dhe për punësimin e personave me aftësi të kufizuara

Sadik Idriz – Tha se Komisioni e ka përgatitur raportin përfundimtar lidhur me Projektligjin për rehabilitimin profesional dhe për punësimin e personave me aftësi të kufizuara. Komisionet kryesore e kanë përkrahur raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL. Amendamenti i deputetes Teuta Hadri procedohet në seancë pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL.

4. Të ndryshme

a) Ligji nr 03/L110 “Për ndërprerjen e shtatzënisë”

Sadik Idriz – I njoftoi anëtarët e Komisionit se kryetari i Republikës së Kosovës e ka kthyer për rishqyrtim Ligjin për ndërprerjen e shtatzënisë, por ende nuk e ka marrë një arsytim lidhur me këtë.

b) Raporti i Organizatës Botërore të Shëndetësisë për gjendjen në shëndetësi

Qamile Morina – Tha se Organizata Botërore e Shëndetësisë e ka bërë raportin për gjendjen në sistemin shëndetësor. Raporti u është dërguar deputetëve Sadik Idriz dhe Armend Zemaj që kanë marrë pjesë në këtë konferencë. Kërkoj që këtë raport ta kenë të gjithë deputetët.

Nurishahe Hulaj – Tha se ajo që ka bërë OBSH-ja është më tepër një analizë për gjendjen në shëndetësi, se sa një raport.

Armend Zemaj – Tha se ka marrë pjesë në këtë konferencë lidhur me analizën që e ka bërë OBSH-ja për gjendjen në shëndetësi. Në atë takim nuk ka pasur debat. Ai i ka përshëndetur të pranishmit në emër të Komisionit, meqë kryetari i Komisionit e ka ngarkuar të marrë pjesë në këtë konferencë.

Mbledhja përfundoi në orën 12:36

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryesuesi i Komisionit

Sadik Idriz